ANALIZË E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS - 14 SHKURT 2021

VOTIMI JASHTË VENDIT 2021

Të drejtat autoriale ©2014 - 2021. GERMIN
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përveç citimeve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, fotokopjues, ose tjetër, pa lejen paraprake të autorit.

Lista e akronimeve

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

LZP - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

PZAP - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

QNR - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

QTP – Qendra Tranzite Postare

SKQZ - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1. HYRJE **7**

2. E DREJTA E VOTËS NGA JASHTË VENDIT **9**
RËNDËSIA E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT DHE DIASPORA

3. KORNIZA LIGJORE **11**
REGJISTRIMI I VOTUESVE NGA JASHTË VENDIT

4. VOTIMI NGA JASHTË KOSOVËS 2021
REZULTATET
PARTITË DHE KANDIDATËT MË TË VOTUAR NGA JASHTË
PAKOT ME FLETËVOTIME TË ARDHURA PAS AFATIT LIGJOR

5. KOSTOJA FINANCIARE E ORGANIZIMIT TË VOTIMIT NGA JASHTË KOSOVËS **35**

6. PENGESAT NË PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT **38**

7. ALTERNATIVAT E VOTIMIT NGA JASHTË KOSOVËS **41**
VOTIMI FIZIK NË MISIONET DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZGJERIMI I MUNDËSIVE PËR VOTIM PËRMES POSTËS
VOTIMI ELEKTRONIK

8. BIBLIOGRAFIA **45**

9. SHTOJCA **47**
PËRPJEKJET E GERMIN PËR MBROTJEN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR DIASPOREN

HYRJE

Qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen njësoj sikurse të gjithë të tjerët që jetojnë në Kosovë. Republika e Kosovës përmes Kushtetutës[1] dhe legjislacionit të saj mundëson ushtrimin e të drejtave zgjedhore për të gjithë qytetarët pa dallim, pavarësisht vendit ku ata jetojnë. Të drejtat zgjedhore hyjnë në kuadrin e të drejtave themelore, dhe garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi por edhe me dokumente/konventa ndërkombëtare.

Në Kosovë **votimi nga jashtë vendit lejohet për të gjitha llojet e zgjedhjeve.** Qytetarët jo-rezident mund të votojnë përmes postës në Zgjedhjet Lokale apo Qendrore, pasi të jenë regjistruar suksesshëm për votim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Mirëpo, edhe pse ekziston një numër i madh i qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe interesimi për të votuar nga jashtë është ndër vite, pjesëmarrja e tyre në Zgjedhje në Kosovë vazhdon të jetë një proces i ndërlikuar, i përcjellur me probleme të përsëritura.elektoral jashtë vendit ta ketë të vështirë pjesëmarrjen në proceset demokratike në Republikën e Kosovës, gjë e cila ka ndikuar edhe në uljen e besueshmërinë karshi institucioneve.

Pavarësisht vlerësimit pozitiv për ecurinë e zgjedhjeve brenda vendit, votimi nga jashtë vazhdon të mbetet problematik gjatë proceseve zgjedhore në Kosovë. Problemet me regjistrimin, dërgimin dhe pranimin e zarfeve me fletëvotime nga jashtë si dhe mungesa e informimit dhe edukimt të duhur të votuesve, kanë përcjellë pothuajse çdo cikël zgjedhor. Këto dhe probleme të tjera nuk janë adresuar nga institucionet relevante dhe ndryshimet sipërfaqësore si mundësimi i aplikimit për regjistrim përmes e-mailit nga viti 2017, nuk kanë përmirësuar procesin, gjë që u dështua edhe me zgjedhjet e 14 shkurtit 2021.

Kjo analizë synon të adresojë pengesat në procesin e votimit nga jashtë dhe ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha operacioneve zgjedhore në kuadër të tij. Analiza paraqet të dhënat dhe rezultatet e votimit nga jashtë gjatë zgjedhjeve të fundit për Kuvendin e Kosovës të vitit 2021.

---

[1] Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 45 par 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.

Kjo analizë synon të adresojë pengesat në procesin e votimit nga jashtë dhe ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha operacioneve zgjedhore në kuadër të tij. Analiza paraqet të dhënat dhe rezultatet e votimit nga jashtë gjatë zgjedhjeve të fundit për Kuvendin e Kosovës të vitit 2021.

Në këtë dokument trajtohen:

- e drejta dhe rëndësia e votës nga jashtë,
- korniza ligjore mbi procedurat e regjistrmit dhe votimit nga jashtë për zgjedhjet në Kosovë,
- rezultatet e votave nga jashtë për Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021,
- kostoja financiare e votimit nga jashtë,
- pengesat kryesore në kuadër të këtij procesi,
- alternativat e votimit nga jashtë në Kosovë.

Po ashtu, në pjesën e fundit jepen rekomandime konkrete për institucionet relevante për ndryshimet që duhen bërë për tejkalimin e pengesave dhe zgjidhjes së problemeve në këtë process, me qëllim të zgjerimit të mundësive për votim nga jashtë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

E DREJTA E VOTËS NGA JASHTË VENDIT

RËNDËSIA E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT DHE DIASPORA

Përfshirja e diasporës në proceset politike është mjet i rëndësishëm që një shtet e ka për të mbajtur të forta lidhjet me qytetarët jashtë vendit. Ndër aspektet e ndryshme të vendit të origjinës në të cilin diaspora duhet të përfshihet ngushtë, pjesëmarrja politike është mbase njëra nga më të rëndësishmet.

Votimi nuk është vetëm forma më e rëndësishme e pjesëmarrjes politike, por edhe mënyra më e mirë për t'i bërë zërat e diasporës të dëgjohen. Poashtu, ofrimi i mundësive për të ushtruar të drejtën e votës tregon edhe për interesimin e shtetit për të trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim të vendit ku jetojnë, dhe sidomos atyre që vazhdojnë të kultivojnë marrëdhënie me shtetin amë edhe pse jetojnë në një shtet tjetër. Një gjë të tillë e konfirmon edhe raporti për votimin jashtë vendit i Komisionit të Venedikut për vitin 2011, ku votimi nga jashtë vlerësohet si një mekanizëm i trajtimit të barabartë midis qytetarëve që banojnë në vend dhe anëtarëve të diasporës.[2] Sipas Komisionit të Venedikut, është në diskrecionin e shteteve të të përfshijnë në legjislacionin e tyre të drejtën e votimit nga jashtë. Mirëpo, kur shtetet u`a japin të drejtën qytetarëve jo-rezidentë për të votuar, atëherë ato duhet të sigurojnë të gjitha mundësitë për ushtrimin e kësaj të drejte në mënyrë të barabartë për të gjithë. Më tej, votimi i diasporës është edhe mjet shtesë për ruajtjen e përkatësisë kombëtare dhe forcimin e identitetit etnik, duke qenë se pjesëmarrja në vendmmarrje ndikon në rritjen e afërsisë dhe besnikërisë së diasporës me insitutcionet dhe shoqërinë e vendit amë.

Kosova konsiderohet si shtet me diasporë të madhe në proporcion me numrin e përgjithshëm të qytetarëve vendas. Burime të ndryshme dëshmojnë se jashtë vendit jetojnë diku mes të 400.000 dhe 600.000 qytetarë të Kosovës, të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës, përderisa numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të diasporës shkon prej 800,000 deri ne 1 milionë.[3]

---

[2]"Raporti mbi Votmin Jashtë Vendit". 2011. Komisioni i Venedikut. https://www.ven ice.coe.int/ëeb-forms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)022-e.

[3]Krasniqi, Lirim. 2018. "Vota e Diasporës si Infuzion i Demokracisë". *GERMIN & KALLXO.Com.* https://kallxo.com/gjate/mendime/vota-e-diaspores-si-infuzion-i-demokracise/.

Sipas të dhënave nga Raporti i Migrimit të vitit 2014 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), janë mbi 380,000 qytetarë që kanë lindur në Kosovë por që jetojnë jashtë saj, ndërsa mbi 50% e emigranteve janë të vendosur në Gjermani dhe në Zvicër.[4] Ndërkohë, vlerësohet se mbi 300.000 qytetarë jashtë vendit janë me të drejtë vote.[5] Pas vitit 2014 nuk eshte publikuar ndonje raport i ri i migrimit nga ASK as nga ndonje institucion tjeter, por vlerësohet se numri i qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës është rritur.

Diaspora e Kosovës ka qenë historikisht afër vendit të origjinës. Që nga vitet e 70-ta, ajo ka qenë një mirëmbajtëse e 'paqes sociale' përmes dërgimit të remitencave, të cilat kanë qenë burimi i vetëm financiar për shumë familje kosovare dhe kontribuese e rëndësishme në të gjitha proceset politike dhe shoqërore. Diaspora vazhdon të jetë kontribuese e madhe në ekonominë e Kosovës përmes dërgesave financiare dhe sipas të dhënave të Bankës Qendrore, remitancat perbejne rreth 15% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Nëse kësaj i shtojmë edhe shpenzimet që diaspora i kryen gjatë vizitave në Kosovë dhe investimet, atëherë mund të vlerësojme se ndikimi ekonomik i diasporës në Kosovë është shumë i madh.

Përderisa është bërë njëfarë përparimi në njohjen e rëndësisë së diasporës, shumë pak është bërë në aspektin e përfaqësimit politik dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

[4]"Migrimi Kosovar". 2014. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf.

[5]"Vendosja e Drejtësisë Në Zgjedhje: Shqyrtimi i Rasteve dhe Rruga Drejt Bashkëpunimit Institucional". 2015. Democracy for Development (D4D). https://d4d-ks.org//assets/2015-07-10-Electoral-Justice-Report-ALB.pdf.

KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës në lidhje me votimin nga jashtë ka për bazë statusin e personave që jetojnë jashtë vendit. Fillimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 45 par 1 ka përcaktuar se "**Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor**,, Ndërsa neni 45 par 3 ka përcaktuar se "**Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.**,

Pastaj, rëndësi i kushtohet kualifikimit të personave si qytetarë që jetojnë jashtë vendit apo pjesëtarë të diasporës. Sipas Nenit 2 të Ligjit 04/L-215 për Shtetësinë, pjesëtar i Diasporës është "çdo person që e ka qëndrimin e ligjshëm jashtë Republikës së Kosovës i cili dëshmon se ka lindur në Republikën e Kosovës, pjesëtar i diasporës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit që ka lindur në Republikën e Kosovës." [6]

Ndërsa, rreth të pasurit e zotësisë juridike për të marrë pjesë në zgjedhje, Ligji 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 5, thekson se "çdo person ka të drejtë të votojë në zgjedhje nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kritereve vijuese: është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998; ka fituar statusin e refugjatit."[7]

REGJISTRIMI I VOTUESVE NGA JASHTË VENDIT

Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), harton kriteret procedurale për qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës dhe duan të votojnë për zgjedhjet në Kosovë. Për t`u përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës, kriteret që duhet të dëshmohen sipas KQZ-së janë:

---

[6]Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-034 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Neni 2.

[7]Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Neni 5.

- Identiteti,
- Mosha,
- Të qenit pjesë e regjistrit civil në Republikën e Kosovës, ose
- Të qenit banor i Kosovës më 1 janar 1998, dhe
- Përmbushja e kritereve të zotësisë juridike civile:
  a) Të jeni lindur në Kosovë,
  b) Të keni njërin prind të lindur në Kosovë,
  c) Të keni jetuar në Kosovë për një periudhë të pandërprerë prej së paku pesë (5) vite radhazi,
  d) Të jeni detyruar të largoheni nga Kosova prandaj nuk keni pasur mundësi të banoni në Kosovë gjatë një periudhe vijuese prej pesë vjetësh,
  e) Të jeni fëmijë në varësi nën moshën 18 vjeçare (por që mund t'i mbushni 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve) të personit të regjistruar në Regjistrin Civil në Kosovë,
  f) Të jeni person në varësi nën moshën 23 vjeçare, i një personi të regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës dhe të jeni student i rregullt i një institucioni të njohur të arsimit.[8]

Për të dëshmuar përmbushjen e këtyre kritereve për votim nga jashtë, dërgohet aplikimi në adresë të KQZ-së nëpërmjet postës elektronike (e-mail), postës apo faksit. Më pastaj, KQZ e shqyrton nëse personi ka të drejtë të votojë dhe informon atë mbi pranimin apo refuzimin e aplikacioneve në bazë të kushteve të parashtruara për regjistrim. Qytetarit të cilit i refuzohet aplikacioni për votim jashtë vendit, i lejohet që të apelojë vendimin e KQZ-së në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti i pranimit të refuzimit, me postë apo duke paraqitur personalisht apelin.

8"Procedura për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës: Votimi jashtë Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). http://ëëë.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/ (Qasur me 20 shkurt, 2021.)

Atyre të cilëve i`u është aprovuar kërkesa për regjistrim si votues jashtë Kosovës, KQZ-ja u`a dërgon një njoftim përmes postës elektronike dhe shpall listën e personave me të drejtë vote, të regjistruar si votues jashtë vendit. Deri në vitin 2017, KQZ ka përdorur metodën e njoftimit përmes postës fizike, përmes së cilës ka dërguar në adresë të personave të regjistruar një fletëvotim të paplotësuar dhe listën e kandidatëve, udhëzimet mbi mënyrën e votimit si dhe adresën e KQZ-së ku votuesit duhet ta dërgojnë zarfin me fletëvotim.

Nga viti 2017, KQZ ka filluar edhe përdorimin e postës elektronike për procedurat e aplikimit dhe njoftimit të votuesve nga jashtë, duke zgjeruar mundësitë dhe përshpejtuar procesin e komunikimit me votuesit. Ndërsa në Zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2021 nuk është përdorur fare posta fizike për njoftimin e votuesve jashtë vendit. Ky ndryshim sado i vogël ka efekte pozitive për KQZ-në dhe votuesit, si në aspektin financiar por edhe ambientalist.

Regjistrimi për votim jashtë vendit është periudhë e veçantë e cila mund të zgjasë deri në katërdhjetë (40) ditë gjatë zgjedhjeve të rregullta dhe mund të shkurtohet deri në shtatë (7) ditë gjatë zgjedhjeve të parakohshme apo jashtëzakonshme. Sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 03/2013, neni 3.5, në zgjedhjet e rregullta, periudha përfundon 60 ditë para ditës së zgjedhjeve.[9] KQZ shqyrton të gjitha aplikacionet për të përcaktuar të drejtën e aplikuesve për votim dhe shpall listën përfundimtare të votuesve nga jashtë disa ditë para fillimit të periudhës së votimit, duke mundësuar sfidimin apo apelimin e listës nga personat të cilët nuk janë përfshirë në të.

[9] Ky afat është përshtatur me periudhën e konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve, e cila duhet të përfundoj deri në 40 ditë para ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, afati mes 60 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, është përcaktuar për periudhën e kundërshtimit, ku lista e votuesve (që përfshin votuesit brenda dhe jashtë vendit) të kundërshtohet dhe konfirmohet përgjatë kësaj periudhe.

Në Zgjedhjet e Parakohshme të vitit 2021, afati për regjistrim si votues jashtë Kosovës ka zgjatur 8 ditë e 18 orë, nga data 13 - 21 janar në ora 18:00. Ky afat ishte 3 ditë e 6 orë më i shkurtër se në Zgjedhjet e vitit 2019 dhe 1 ditë e 18 orë më i gjatë se zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2014. Gjithsesi, edhe duke pasur parasysh numrin rekord të aplikuesve në 2021, ky afat konsiderohet i shkurtër për regjistrim.

Tabela 1. Afatet e regjistrimeve dhe numri i aplikimeve për votim nga jashtë gjatë 5 cikleve të fundit zgjedhore

	2010	2014	2017	2019	2021
Afati i regjistrimit për votim jashtë vendit	N/A	7 ditë	7 ditë	12 ditë	8 ditë e 8 orë
Nr. i aplikacioneve të pranuara	5,015	29,745	20,354	40,313	130,16
Nr. i aplikacioneve të aprovuara (% nga aplikacionet e pranuara)	1,640 (32%)	16,569 (55%)	15,118 (74%)	35,087 (87%)	102,467 (78%)
Nr. i shteteve nga kanë ardhur aplkacionet	32	40	59	53	67

Gjatë periudhës së regjistrimit KQZ pranoi 175,273 aplikacione në sistem, nga të cila i kanë të regjistruara me sukses 130,168, kjo pasi që 45,105 janë si rezultat i duplifikimit gjatë aplikimit. Nga aplikacionet e regjistruara janë aprovuar 102,467 aplikacione dhe të refuzuara 27,701.

Aplikacionet për votim jashtë vendit janë pranuar nga gjithsej 67 shtete, nga të cilat aplikacionet nga Gjermania (43,049) dhe Zvicra (26,686), përbëjnë mbi 70% të të gjitha aplikacioneve. Vlen të theksohet që në zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 numri i aplikacioneve nga Serbia ka pësuar një rënie të madhe, me vetëm 160 aplikacione të votuesve të aprovuara, nga 4,337 sa ishin në zgjedhjet e vitit 2019.

Dy ditë para fillimit të periudhës së regjistrimit për votim jashtë vendit, me 11 janar 2021 KQZ morri një vendim që të telefononte të gjithë aplikuesit me qëllim të verifikimit të vërtetësisë/autenticitetit të aplikuesit.[10] Ky vendim u apelua nga GERMIN [11] dhe Lëvizja-



[10] Për më shumë, shih Vendimin për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës. I qasshëm në: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/42-2021-Vendim-per-verifikimin-e-apliakcioneve_11-01-2021_1_al.pdf, së bashku me Udhëzimin Administrativ Nr.01/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës. I qasshëm në: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/59-2021-Vendim-per-udhezim-nr-01-2021_12-01-2021_1_al.pdf

[11] Për më shumë, shih ankesën e plotë të GERMIN në PZAP. E qasshme në: https://germin.org/wp-content/uploads/2021/01/Ankesa_PZAP_1_Zgjedhjet_2021-2.pdf, së bashku me ankesën në Gjykatën Supreme; e qasshme në: https://germin.org/wp-content/uploads/2021/01/Ankesa_Gjykata_Supreme_2021-1.pdf

Vetëvendosje pranë PZAP dhe Gjykatës Supreme me arsyetimin se cënon të drejtën e votës, mirëpo këto të fundit i hodhën apelet si të palejuara, pa trajtuar aspektin meritor të tyre, duke e konsideruar vendimin e KQZ të karakterit teknik. Nga ky vendim kufizues pati vonesa, të cilat ndikuan edhe në operacionet tjera zgjedhore lidhur me votimin jashtë vendit. KQZ edhe pse kishte angazhuar staf shtesë prej 110 personash për zbatimin e këtij vendimi, nuk arriti të telefonojë të gjthë aplikuesit sipas planit operacional, duke u detyruar që të pranojë në listën finale të votuesve 36,414 aplikacione, të cilat nuk ishin verifikuar përmes telefonit, por që kishin plotësuar kushtet paraprake formale, pas rekomandimit të SKQZ-së. Vonesat e shkaktuara nga procesi i verifikimit të aplikuesve përmes telefonit afektoi periudhën e votimit dhe pamundësoi në masë të madhe apelimin e listës finale të votuesve nga jashtë, duke qenë se e njejta u publikua në pasditen e vonë të datës 2 shkurt 2021. Periudha e votimit përmes postës filloi me rreth 19 orë vonesë dhe zgjati deri me 12 shkurt.

Ndërkohë, sfidimi apo apelimi i listës përfundimtare të votuesve nga jashtë, ishte një problematikë tjetër gjatë këtij procesi. Kjo për shkak të vendimeve kontraverse të PZAP, e cila fillimisht njoftoi se pranon ankesat vetëm përmes postës, por që një ditë pas njoftoi se "duke u nisur nga vullneti i mirë", ka vendosur që t'i pranoj ankesat e dërguara edhe përmes postës[12] elektronike (e-mailit)[13]. Brenda datës 3 dhe 4 shkurt, PZAP kishte pranuar 1116 emaile me ankesa, prej të cilave vetëm 281 ishin shqyrtuar ngaqë kishin pasur të bashkangjitur formularin e ankesës, ndërsa pjesa tjetër nuk janë shqyrtuar me arsyetimin se nuk kishin formë e as përmbajtje të ankesës.

Nga 281 apelet e shqyrtuara, 144 janë pranuar si të bazuara dhe është urdhëruar KQZ që këta votues t'i përfshijë në listën e votuesve jashtë vendit. Gjithsesi, një numër i madh i personave që nuk janë gjendur në listën e votuesve nga jashtë, nuk kanë pasur mundësi të apelimit të saj. Për këtë, GERMIN në bashkëpunim me zyrën ligjore Hodaj & Partners, ka nisur nj fushatë për mbledhjen e dëshmive nga personat që padrejtësisht nuk janë përfshirë në listën e votuesve jashtë vendit. Këto ankesa janë duke u procesu-ar dhe do të paraqiten pranë insttucionit të Avokatit të Popullit, me kërkesën që rasti të ngritet në Gjykatën Kushtetuese.

Publikimi i listës së votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021 është përcjellë me shqetësim sepse në të janë përfshirë edhe të dhënat personale të qytetarëve që janë regjistruar si votues jashtë vendit. Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 03/2013, Neni 3, pika 3.7,***"KQZ-ja duhet ta përpilojë Listën Votuesve Jashtë Kosovës e cila përmban të dhënat e atyre votuesve që me sukses janë regjistruar për votim jashtë Kosovës dhe t'i largojë emrat e tyre nga Listat e Votuesve që përdoret në vendvotime. Votuesit... "***

Bazuar në praktikën e deritashme, KQZ ka përpiluar dhe publikuar listën e votuesve nga jashtë Kosovës, ku janë përfshirë edhe të dhënat personale të votuesve si datëlindja e plotë. GERMIN konsideron se publikimi i të dhënave të tilla personale në atë mënyrë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Neni 24 - Mbrojtja e të dhënave në mënyrë konkrete dhe rastësore. GERMIN, pas konsultimit me ekspertë të fushës, i ka shkruar zyrtarisht KQZ-së para se kjo e fundit të publikoj listën e votuesve nga jashtë vendit, duke i kërkuar mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve në mënyrë të atillë që do të minimizonte të dhënat e publikuara (shembull: në datëlindje të vendoset 2*.1*.1986). Kjo formë do të integronte garancitë e nevojshme në përpunim, me qëllim që të përmbushen kërkesat e e ligjit dhe për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe do të u`a mundësonte atyre identifikimin brenda listës. Gjithsesi, kjo kërkesë nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga ana e KQZ-së.

[12]GERMIN kishte kërkuar zyrtarisht nga PZAP që të pranoj ankesat përmes e-mailit, mirëpo përgjigja e tyre ishte negative, me arsyetimin se "nuk mund të ofrojnë diçka që nuk parashihet me ligj".

[13]Për më shumë, shih njoftimin e PZAP për të mospranuar ankesat përmes e-mailit. E qasshme në: https://pzap.rks-gov.net/?p=10218&fbclid=IwAR17iRzwu4ce-Nacf73TDeAgYe9h758c4dIXsJfoTVD0veWOO53o-dKQ_TAw, së bashku me njoftimn për pranimin e ankesave përmes e-mailit; i qasshëm në: https://pzap.rks-gov.net/?p=10221&fbclid=I-wAR1KqAM5QI7nJ_hSmc5Z8_SU3WdA_MKTNtbBeAZJcmAIJIIumLhlWpW2tuA

[14]Për më shumë, shih njoftimin e GERMIN për mundësinë paraqitjes së ankesës përmes e-mailit. E qasshme në:https://germin.org/ankohu-ndaj-refuzimit-te-aplikacionit-per-votim-nga-jashte-kosoves/

VOTIMI NGA JASHTË KOSOVËS 2021

Në vitin 2013, KQZ-ja ka miratuar një Rregull të veçantë Zgjedhore (Nr. 03/2013) ku përcaktohen procedurat për votim nga jashtë[15]. Të gjithë personat e regjistruar suksesshëm si votues nga jashtë kanë pasur mundësi ta shkarkojnë fletëvotimin në ueb-faqen zyrtare të KQZ-së, pa pasur nevojë që të presin fletëvotimin origjinal që vinte me postë fizike në vitet paraprake. Sipas Rregullës Nr. 03/2013, Neni 4.2, votuesi jashtë Kosovës, *"pas plotësimit të fletëvotimit(eve) votuesi duhet të vendosë fletëvotimin(et) në një zarf të pashënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj."*[16]

Pas plotësimit të fletëvotimit dhe futjes në zarf sipas kritereve të vendosura nga KQZ, votuesi duhet ta dërgojë zarfin apo pakon me fletëvotime me postë në njërën nga kutitë postare të KQZ-së, deri në datën e përcaktuar nga kjo e fundit e që sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme duhet të jetë një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Pas shpalljes së listës së votuesve nga jashtë, ata të cilët ishin pjesë e saj duhej të dërgonin votat përmes postës brenda afatit 2-12 shkurt 2021. Por, siç u tha më lartë, procesi i telefonimit të të gjithë aplikuesve për të votuar nga jashtë vonoi edhe periudhën e votimit, ku fillimisht duhej të dërgoheshin nga data 02-12 Shkurt 2021. Mirëpo, për shkak të mos publikimit të listës së votuesve në kohë, periudha e votimt filloi me rreth 18 orë vonesë, më saktësisht pas orës 18:00 të datës **2 shkurt 2021.**



[15] Për më shumë shih: RREGULLA ZGJEDHORE Nr.3/2013 - VOTIMI JASHTË KOSOVËS". 2013. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Neni 4.2. http://ëëë.kqz-ks.org/ëp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf.

[16] RREGULLA ZGJEDHORE Nr.3/2013 - VOTIMI JASHTË KOSOVËS". 2013. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Neni 4.2. http://ëëë.kqz-ks.org/ëp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf.

Deri me datë 12 shkurt ora 24:00, në adresë të KQZ arritën 43,447 pako të supozuara me fletëvotime. Nga ky numër i pakove të arritura janë verifikuar 43,063 zarfe, 320 prej të cilave kanë qenë pako të dërguara brenda Republikës së Kosovës si dhe 64 zarfe të tjera të pa hapura, të cilat ishin material hetimi për prokurorinë e shtetit të Kosovës. Këto pako me fletëvotime kanë arritur përmes disa shërbimeve postare si: Posta e Kosovës dhe postave private që ofrojnë transport të shpejt si DHL, UPS dhe TNT. Në figurat e mëposhtme mund të gjeni të detajuara sasinë e pakove të pranuara nga zyrtarët e KQZ sipas postës së dërgimit/pranimit nga të dhënat e nxjerra prej ekipit vëzhgues të GERMIN.

Figura 1. Pakot me fletvotime të pranuara nga KQZ brenda afatit sipas postës

E DREJTA E VOTËS NGA JASHTË VENDIT

Nga 43,063 pako me fletëvotime të verifikuara rezultuan 79,201 votues apo fletëvotime, prej të cilave u aprovuan 56,610 dhe u refuzuan 22,591. Procesi i verifikimit të pakove me fletëvotime filloi me datë 15 shkurt dhe zgjati dy javë, deri me 1 mars 2021. Për verifikimin e fletëvotimeve të ardhura me postë fillimisht janë angazhuar 36 zyrtarë nga KQZ, mirëpo për shkak të ecurisë së ngadalshme, ky numër është rritur në 45, me qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të procesit.

Tabela 2. Të dhënat nga procesi verifikimit të pakove fletëvotime nga jashtë

Gjithsej zarfa të arritur	43,447
Gjithsej zarfa të hapur	43,063
Gjithsej votues	79,201
Gjithsej fletëvotime të aprovuara	56,610 nga të cilat 56,375 të vlefshme
Gjithsej fletëvotime të refuzuara	22,591

Tabela 3. Arsyet e refuzimit kanë qenë të ndara në disa kategori

Kodi i refuzimit	Arsyet e refuzimit	Numri i të refuzuarve
D1	Personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim	9,199
D2	Aplikuesit e refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim	6,665
D4	Personat që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë	1,325
D5	Personat që nuk janë identifikuar (që kanë dërguar vetëm fletëvotim) dhe persona që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se persona të aprovuara	2,451
D6	Personat që nuk kanë dëshmuar identitetin me dokumente valide të identifikimit (që kanë dërguar kopje të dokumenteve me afat të skaduar)	910
D7	Numri i pakove me fletëvotime për këtë kategori janë refuzuar për arsye se pakoja përmban numër të fletëvotimeve jashtë rrethit të ngushtë familjarë.[17]	1,656
D8	Pako me fletëvotime që janë dorëzuar personalisht në postën numër 6.[18]	385

Edhe në këto zgjedhje, sikurse në ato të kaluarat, diferenca mes votuesve të regjistruar dhe votave të konfirmuara nga jashtë apo përmes postës është e lartë. Përqindja e fletëvotimeve të konfirmuara në krahasim me numrin e votuesve të regjistruar suksesshëm në katër ciklet e fundit të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës është si vijon:

[17] Për kategorinë "D7" janë dërguar 153 pako me fletëvotime që tejkalojnë rrethin e ngushtë familjarë. Numri i pakove të individualizuar me fletëvotime, të refuzuar sipas kësaj kategorie përmban gjithsejtë: Njëmijë e gjashtëqind (1,656 zarfe të individualizuara me fletëvotime (shembull: brenda një pako me fletëvotime kanë qenë 84 zarfe të individualizuara me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjarë, 39, 37, 35, 33, 30 zarfe të individualizuara me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjarë, etj.,)

[18] Pakot me fletëvotime sipas kategorisë së refuzimit "D8" nuk përmbajnë vulën dhe pullën postare të postës dërguese.

Tabela 4. Numri i votuesve të regjistruar dhe atyre që kanë pjesë në zgjedhje përmes postës

Viti	Numri i votuesve të regjistruar për votim përmes postës	Numri i votuesve që kanë dërguar fletëvotimin përmes postës	% e pjesëmarrjes në votim përmes postës
2021	102467	56610	55.25%
2019	35087	20191	57.57%
2017	15118	5201	34.70%
2014	16569	10446	64.26%
2010	1640	1053	64.21%

Figura 2. Përqindja e pjesëmarrjes në zgjedhje e votuesve të regjistruar nga jashtë



Një element tjetër me rëndësi ishte ai i evidentimin të zarfeve që vinin përmes Qendrës Tranzite Postare (QTP). Kjo për shkak se GERMIN, pas një hulumtimi për zgjedhjet e kaluara kishte vërejtur se zarfet që kishin kaluar përmes kësaj qendre nuk ishin vulosur me 'vula datare në ardhje', një veprim ky që ishtë në kundërshtim me udhëzimin administrativ Nr. 2005/4 Për Rregullimin e Shërbimeve Univerzale Postare. Arsyetimi i atëhershmë i zyrtarëve përgjegjës ishte se kishin pasur mungesë të materialit për vulosjen e zarfeve. Për zgjedhjet e 14 shkurtit, ky element u përmirësua dhe QTP ishte e përgatitur para fillimit të zgjedhjeve me të gjitha materialet e nevojshme.

[19]Për më shumë, shih njoftimin e GERMIN për këtë çështje. I qasshëm në: https://germin.org/wp-content/uploads/2020/12/raporti_vota_e_diaspores_2019_posta_e_kosoves_.pdf

REZULTATET E PËRGJITHSHME

Ndërkohë, vërehet një rritje relativisht e lartë e numrit të votave të konfirmuara, të ardhura nga shtetet ku diaspora e Kosovës është më e koncentruar. Shtetet nga ku janë dërguar më së shumti vota janë Gjermania dhe Zvicra, të cilat përbëjnë burimin e mbi 75% të të gjitha votave nga jashtë Kosovës. Në tabelën e më poshtme janë të shfaqura fletvotimet e konfirmuara sipas shteteve kryesore në krahasim me zgjedhjet e vitit 2019:

Tabela 5. Numri i votave të ardhura me postë sipas shteteve dërguese në dy palë zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës

	SHTETET	2021	2019
	Gjermani	26,472	7,684
	Zvicër	17,010	7,077
	Austri	3,183	860
	Suedi	1,550	633
	Francë	1,532	643
	Itali	1,400	548
	SHBA	869	483
	Mbretëria e Bashkuar	828	308
	Norvegji	639	261
	Kanada	469	61
	Danimarkë	435	138
	Serbi	19	3,782
	TË TJERA	2,639	1,494
	TOTALI	56,610	20,199

Sa i përket votave të konfirmuara nga jashtë sipas komunave në Kosovë, Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Prizreni dhe Peja janë 5 komunat me më së shumti vota. Siç vërehet në tabelën nr. 6, renditja e komunave kryesore për votat e konfirmuara nga jashtë është e ngjashme me zgjedhjet e vitit 2019.

Tabela 6. Fletvotimet e konfirmuara nga jashtë sipas komunave në dy palë zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës

Komuna	2021	2019	Komuna	2021	2019
Prishtinë	5,524	1,367	Gllogoc	888	267
Gjilan	4,059	838	Dragash	824	147
Ferizaj	3,883	907	Fushë Kosovë	820	193
Prizren	3,735	1,017	Shtime	817	233
Pejë	3,216	883	Obiliq	515	138
Gjakovë	2,851	821	Juniku	269	100
Suharekë	2,623	657	Mamushë	162	N/A
Podujevë	2,561	618	Hani i Elezit	124	N/A
Mitrovicë e Jugut	2,149	574	Shtërpcë	93	N/A
Vushtrri	2,083	534	Novobërdë	81	N/A
Rahovec	1,897	429	Kllokot	34	N/A
Viti	1,775	463	Mitrovicë e Veriut	34	N/A
Kamenicë	1,642	432	Zubin Potok	33	N/A
Lipjan	1,542	376	Graçanicë	27	N/A
Istog	1,527	410	Leposaviq	11	123
Deçan	1,498	446	Zveçan	8	N/A
Malishevë	1,345	350	Ranillug	5	N/A
Skenderaj	1,257	376	Partesh	1	N/A
Klinë	1,120	292	Të përziera[1]	4596	6,954
			TOTALI:[20]	56,610	20,199

[20]Për 4,595 vota të konfirmuara nga jashtë nuk është arritur të identifikohet Komuna në Kosovë.

Figura 3. Fletvotimet e konfirmuara nga jashtë sipas komunave në dy palë zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës



Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 shënuan rekordin më të lartë të votave të dërguara me postë, si në numër po ashtu edhe në përqindjen e totalit të votave totale. Për herë të parë votat e konfirmuara dhe të vlefshme nga jashtë përbëjnë 6.3% të numrit total të qytetarëve që votuan në zgjedhje. Nëse e krahasojmë totalin e votave nga diaspora me pragun zgjedhor për partitë politike për të fituar ulëse në parlament (5%), atëherë votat nga jashtë në këto zgjedhje do të arrinin tejkalimin e këtij pragu. Në përkthim të mandateve në Kuvend, votat nga jashtë në këto zgjedhje janë ekuivalente me 7 mandate/deputetë.

Tabela 7. Pjesëmarrja e votuesve nga jashtë në katër ciklet e fundit zgjedhore për Kuvendin e Kosovës

	2014	2017	2019	2021
Afati i votimit	11 ditë	14 ditë	11 ditë	10 ditë e 6 orë
Nr. i pakove të pranuara me fletëvotime	N/A	9,157	24,523	43,447
Votues të regjistruar	15,569	15,118	35,087	102,467
Nr. i fletëvotimeve të konfirmuara	10,446	5,201	20,191	56,610
Fletëvotimet e konfirmuara nga jashtë si përqindje e numrit total të qytetarëve që votuan me 14 shkurt	1,4%	0,7%	2,3%	6,3%

PARTITË DHE KANDIDATËT MË TË VOTUAR NGA JASHTË

Lëvizja Vetëvendosje ishte subjekti më i votuar në dy palë zgjedhjet e fundit nga votat e ardhura nga jashtë. LVV mori 44,252 vota nga jashtë, PDK mori 5,032, LDK mori 4,294 vota, AAK mori 1,112 vota, Nisma mori 441 vota, dhe partitë tjera morën 1,244 vota. Figura 3 paraqet votat nga jashtë të fituara nga subjektet kryesore politike shprehur në përqindje në dy palë zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës.

Figura 3. Rezultatet e votave nga jashtë vendit sipas subjeketeve politike në dy palë zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës, shprehur në përqindje.



Ndërkohë, votat nga jashtë në këto zgjedhje kanë pasur ndikim edhe në përqindjet totale të partive politike. Janë tre subjekte politike, të cilat rret 10% të totalit të votave të tyre i kanë fituar nga votimi jashtë Kosovës. Tabela 8 paraqet votat nga jashtë për secilin subjekt dhe përqindjen e tyre nga totali i votave të subjektit.

Tabela 8. Rezultatet e votave nga jashtë për secilin subjekt politik garues në Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 1/2

Subjekti	Nr. votave nga jashtë	Votat totale të subjektit	% nga votat totale të subjektit
Lëvizja Vetëvendosje-LVV	44,252	438,335	10.10%
Partia Demokratike e Kosovës-PDK	5,032	148,285	3.39%
Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK	4,294	110,985	3.87%
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK	1,112	62,111	1,79%
Nisma Socialdemokrate	441	21,997	2.00%
Srpska Lista	0	44,407	0.00%
Kosova Demokratik Türk Partisi-KDTP	150	6,496	2.31%
Koalicija Vakat	66	5,366	1.23%
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK	355	3,305	10.74%
Romani Iniciyativa-RI	1	3,172	0.03%
Nova Demokratska Stranka -NDS	23	2,885	0.80%
Socialdemokratska Unija -SDU	30	2,549	1.18%
Partia Liberale Egjiptiane -PLE	66	2,430	2.72%
Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hodžić-Uz-Ah	4	2,217	0.18%

Tabela 8. Rezultatet e votave nga jashtë për secilin subjekt politik garues në Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 2/2

Subjekti	Nr. votave nga jashtë	Votat totale të subjektit	% nga votat totale të subjektit
Jedinstvena Goranska Partija -Jgp	0	2,161	0.00%
Partia e Ashkalinjëve Për Integrim-PAI	212	2,138	9.92%
Partia Demokratike e Ashkanlive Të Kosovës-PDA	145	1,960	7.40%
Gi Za Slobodu Pravdu I Opstanak-Gi Spo	0	1,508	0.00%
Naša Inicijativa-Naša	49	1,375	3.56%
Lëvizja Për Bashkëveprim-LPB	32	1,261	2.54%
Yenilikçi Türk Hareket Partisi-YTHP	12	1,243	0.97%
Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës-LPRK	26	1,208	2.15%
Fjala	29	1,087	2.67%
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës-PREBK	4	1,074	0.37%
Koalicija Zajedno	18	1,010	1.78%
Kosovaki Nevi Romani Partia -KNRP	22	600	3.67%
Srpski Demokratski Savez-SDS	0	476	0.00%
Partia Balliste-PB	0	155	0.00%

Votat nga jashtë Kosovës duket të ketë pasur ndikim shumë të madh edhe tek kandidatët. Nga 20 kandidatët më të votuar nga diaspora, 40% janë gra dhe 60% burra. Për 20 kandidatët më të votuar nga jashtë, pjesëmarrja mesatare e numrit të votave nga jashtë në numrin total të votave të kandidatëve është rreth 13%.

Tabela 9. 20 kandidatët më të votuar nga jashtë Kosovës në Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021

	Emri i kandidatit	Nr. votave nga jashtë	Nr. total i votave të kandidatit	% e votave nga jashtë në totalin e votave të kandidatit	Subjekt
1	VJOSA OSMANI	33,323	300,756	11,08%	LVV
2	GLAUK KONJUFCA	31,092	200,646	15,50%	LVV
3	ARBEN VITIA	16,664	107,858	15,45%	LVV
4	DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ	15,234	71,722	21,24%	LVV
5	MIMOZA KUSARI-LILA	10,906	53,618	20,34%	LVV
6	ARMEND MUJA	9,910	43,982	22,53%	LVV
7	VASFIJE BLAIR	7,333	60,879	12,05%	LVV
8	AVNI DEHARI	6,401	51,126	12,52%	LVV
9	HEKURAN MURATI	6,342	41,172	15,40%	LVV

10	LIBURN ALIU	4,388	22,520	19,48%	LVV
11	HAXHI AVDYLI	3,872	26,681	14,51%	LVV
12	SARANDA BOGUJEVCI	3,769	26,389	14,28%	LVV
13	ENVER HOXHAJ	3,357	100,468	3,34%	PDK
14	AVDULLAH HOTI	2,733	69,648	3,92%	LDK
15	ARBERIJE NAGAVCI	2,662	21,781	12,22%	LVV
16	FATON PECI	2,548	25,284	10,08%	LVV
17	KUJTIM SHALA	2,083	32,703	6,37%	LDK
18	SHQIPE MEHMETI SELIMI	1,915	18,562	10,32%	LVV
19	MEFAIL BAJQINOVCI	1,681	18,794	8,94%	LVV
20	FITORE PACOLLI DALIPI	1,538	8,797	17,48%	LVV

PAKOT ME FLETËVOTIME TË ARDHURA PAS AFATIT LIGJOR

Gjatë procesit të verifikimit të vlefshmërisë së pakove të ardhura përmes postës, Organizata GERMIN përmes vëzhguesve të saj të akredituar nga KQZ, ka vërejtur se në adresë të KQZ, pas datës 12 shkurt – si afati i fundit për pranimin e votave me postë, e deri me datë 25 shkurt 2021, kanë arritur 9 mijë e 748 pako me fletëvotime. Këto pako nuk janë pranuar nga SKQZ dhe nuk janë procesuar më tej.

Tabela 10. Numri i votave me postë të ardhura pas afatit ligjor në KQZ

Posta	Data	Posta
Posta nr. 6	25.02.2020	9,030
DHL	18.02.2020	691
DHL	19.02.2020	27
Totali: 9,748 pako		

Sa i përket mospranimit të zarfeve me fletëvotime nga jashtë të ardhura pas afatit ligjor, përkatësisht datës 12 shkurt 2021, vendimi nr. KI 207/19 i Gjykatës Kushtetuese ka pamundësuar pranimin dhe procesimin e të njejtave nga KQZ[21]. Ky vendim, edhe pse i padrejtë nga këndvështrimi ynë, është i pakontestueshëm përmes mjeteve juridike në dispozicion, gjë që u dëshmua edhe në vendimin që mori Gjykata Supreme lidhur me ankesat e LVV për këtë çështje, me datë 11 mars 2020

[21] Për më shumë, shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të dates 10 dhjetor 2020: I qasshëm në https://gjk-ks.org/vendimet-nga-seanca-shqyrtuese-e-mbajtur-me-10-dhjetor-2020/

Vendimi KI 207/19, të Gjykatës Kushtetuese të Kovovës i ka paraprirë kërkesa për vlerësimin e kushtetuetshmërisë së dy vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, respektivisht Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe Aktgjykimit [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019, sipas të cilave Gjykata Supreme kishte urdhëruar KQZ-në të pranoj edhe pakot e ardhura pas afatit, me arsyetimin se afati i përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të jetë normë ligjore në kolizion me Kushtetutën, nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe se sipas Ligjit mbi Procedurën Administrative, data e dërgimit të postës është ajo që merret parasysh në praktikën administrative dhe gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës ndaj Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e vendimit të Gjykatës Supreme, Koalicioni "NISMA-AKR-PD", kishte pretenduar se Gjykata Supreme, përmes këtyre dy vendimeve, ka vepruar në kundërshtim: (i) me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 të KEDNJ; dhe, (iii) nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se Gjykata Supreme në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur të aplikojë instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës dhe jo nenin 96.2 të LZP-së dhe nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013.

Lidhur me pretendimin se Gjykata Supreme në kundërshtim me Kushtetutën ka vendosur të aplikoj drejtëpërdrejtë instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës dhe jo dispozitat ligjore, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj ka theksuar se në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata konstatoi se gjykatat e rregullta kanë autorizim kushtetues që të aplikojnë një normë ligjore në harmoni me Kushtetutën, duke përfshirë edhe konventat ndërkombëtare që janë pjesë përbërëse e Kushtetutës. Në nivel parimor, kjo nënkupton që Gjykata Supreme, në rastin konkret, ka qenë në të drejtën e saj të aplikojë drejtpërdrejt normën e KEDNJ-së. Se a është në përputhje me autorizimet e Gjykatës Supreme konstatimi i kolizionit në fjalë dhe se a është i saktë interpretimi i saj në rrethanat e rastit konkret, është nën autoritetin e Gjykatës Kushtetutese që të vendosë përfundimisht.

Në përfundim të Vendimit KI 207/19, Gjykata Kushtetuese kishte theksuar se përkundër faktit që Kushtetuta ua njeh gjykatave të rregullta kompetencën e interpretimit të një norme të rangut ligjor në harmoni me një normë të rangut kushtetues dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të normës së rangut kushtetues, kjo nuk do të thotë se gjykatat e rregullta mund të konstatojnë ose të shpallin një normë ligjore si normë në kundërshtim me Kushtetutën ose KEDNJ-në. Në kuptim të kësaj Gjykata kishte arsyetuar se një kompetencë të tillë, të konstatimit të jokushtetutshmërisë dhe të shfuqizimit të një norme ligjore, Kushtetuta nuk e ka paraparë si kompetencë për gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht sipas Gjykates Kushtetuese, një të drejtë të tillë, Kushtetuta ia ka mveshur në mënyrë ekskluzive vetëm Gjykatës Kushtetuese e cila mund, pas paraqitjes së kërkesës nga një palë e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, të shfuqizojë një normë ligjore që është në kundërshtim me Kushtetutën si dhe të përcaktojë efektet e një shfuqizimi të tillë.

Sa i përket pajtueshmërisë së vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJsë, Gjykata kishte arsyetuar se megjithëse koha për vendimmarrje në kontesteve zgjedhore është relativisht e shkurtër dhe se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së nuk aplikohet në kontestet zgjedhore, kjo nuk nënkupton që vendimet që ndërlidhen me konteste zgjedhore nuk duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara. Gjykata Kushtetuese kishte arsyetuar gjithashtu se sipas GJEDNJ-së, procedura e shqyrtimit të kontesteve zgjedhore duhet të përfshijë patjetër një "vendim mjaftueshëm të arsyetuar" në mënyrë që "të parandalohet abuzimi i pushtetit nga autoriteti relevant vendimmarrës". Pas aplikimit të këtyre parimeve, Gjykata kishte vlerësuar se arsyetimi i Gjykatës Supreme dhe përfundimet e arritura bazuar në atë arsyetim ishin arbitrare dhe nuk plotësonin kriteret e një vendimi mjaftueshëm të arsyetuar gjyqësor. Deri te ky konstatimin, Gjykata Kushtetuese kishte ardhur për faktin se Gjykata Supreme nuk kishte aplikuar asnjë test relevant të shqyrtimit gjyqësor në rrethanat e rastit konkret: (i) çfarë nënkupton "parimi i votimit universal" në të cilin ishte thirrur Gjykata Supreme, si ndërlidhet ai parim me të drejtën e votës nga jashtë dhe si është shkelur i njëjti në rrethanat e rastit konkret; (ii) cilat janë obligimet që neni 3 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së vendosë mbi shtetet përkitazi me votimin nga jashtë; dhe (iii) çfarë është saktësisht ajo që e bën afatin e përcaktuar në nenin 96.2 të LZP në lidhje me nenin 4.4. të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të jetë normë ligjore në kolizion me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se Gjykata Supreme nuk kishte arritur të vërtetojë se si vendimmarrja e PZAP ishte e gabuar dhe se përse linja e arsyetimit të PZAP duhej zëvendësuar me një linjë tjetër që nuk ishte në përputhje me LZP-në dhe praktikën e deritashme zgjedhore.

KOSTOJA FINANCIARE E ORGANIZIMIT TË VOTIMIT NGA JASHTË KOSOVËS

Operacionet e votimit jashtë vendit janë zakonisht shumë më të kushtueshme sesa votimi brenda vendit. Përvoja ndërkombëtare tregon se operacionet e votimit jashtë vendit shpesh kushtojnë të paktën pesë deri në 10 herë më shumë, në varësi të mënyrës se si një votues hedh votën, duke rezultuar në një kosto prej 5-20 dollarë amerikanë për zgjedhës.[22] Mënyra e votimit fizik apo në misione diplomatike konsiderohet si forma më e shtrenjtë nga aspekt financiar e votimit nga jashtë gjersa votimi përmes postës vlerësohet si forma më pak e kushtueshme për institucionet vendore që administrojnë zgjedhjet, por jo edhe për votuesit. Këta të fundit shpesh shpenzojnë më shumë duke votuar përmes postës se sa duke votuar në një qendër votimi në vendin rezident.

Votimi jashtë vendit në Kosovë është një prej operacioneve relativisht të kushtueshme për KQZ-në. Sipas SKQZ, për stafin e angazhuar në këtë proces për zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 janë shpenzuar mbi 200 mijë euro, prej të cilave rreth 75 mijë ishin për stafin e përkohshëm të procesimit të të dhënave dhe 'qendrës së thirrjeve", ndërsa mbi 130 mijë euro për zyrtarët e shërbimit votues. Operaconi i verifikimit me telefon të aplikuesve për regjistrim si votues jashtë vendit, vlerësohet të ketë kushtuar mbi 53 mijë euro. Ndërkohë, një kosto e lartë vlerësohet të ketë pasur edhe procesi i procesimit të aplikacioneve, duke qenë se KQZ këtë proces e kryen manualisht, ku printohen të gjitha emailet e dërguara dhe dokumentet e bashkangjitura në to nga aplikuesit për votim jashtë vendit, të cilat futen pastaj në sistem. Shpenzimeve të lidhura drejtëpërdrejtë me votimin jashtë Kosovës ju shtohet edhe fushata për informim të votuesve, mirëmbajtja teknologjike e emailit dhe elementeve përcjellëse përfshirë elemetet e sigurisë, si dhe kostoja logjistike e procesit të verifikimit të pakove me fletëvotime në QNR. Edhe pse mungojnë të dhënat e sakta dhe të detajuara nga SKQZ për të gjitha shpenzimet, vlerësohet se votimi nga jashtë për zgjedhjet e 14 shkurtit 2021 ka pasur një kosto prej rreth 350 mijë eurosh, e cila vlerësohet të jetë më e lartë në krahasim me shpenzimet e njejta në zgjedhjet e kaluara. Nëse këtë shumë e pjesëtojmë me numrin e votues-ve/votave të konfirmuara nga jashtë (56,610), atëherë i bie se një votues nga jashtë i ka kushtuar KQZ-së mesatarisht 6.2 euro. Kjo shumë është relativisht e ulët, sidomos nëse e krahasojmë me shpenzimet e KQZ për votimin brenda vendit.

[22] Erben, P., Goldsmith, B., & Shujaat, A. 2012. Votimi Jashtë Vendit: Një rishikim i përmbledhur. Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). https://www.eods.eu/library/IFES.Out-of-Country%20Voting,%20A%20Brief%20Overview.pdf

Figura 4. Kostoja e organizimit të votimit jashtë vendit për votues në Kosovë në krahasim me mesataren ndërkombëtare.



Një votues brenda vendit për zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, KQZ-së ka kushtuar 6.3 euro, apo 1.02 herë më e lartë se kostoja e organizimit të votimit jashtë vendit.[23] Kostoja relativisht e ulët për organizimin e votimit jashtë vendit lidhet edhe me mënyrën aktuale të votimi, edhe pse edhe në këtë pike ka hapësirë për efiqencë më të lartë financiare nga ana e KQZ-së.

Por, votimi aktual përmes postës duket të jetë shumë më i kushtueshëm për votuesit. Afatet e shkurtra për dërgimin e zarfeve me fletëvotime kanë bërë që, sidomos në zgjedhjet e fundit, shumë votues të përdorin shërbimet e shpejta (Express) për dërgimin e zarfeve. Këto të fundit vlerësohet të jenë gjashtë herë më të larta se shërbimet normale postare. Nga rishikimi i çmimeve të postës vërehet se për shërbime normale postare, ku dërgesa e zarfit realizohet mes 3 deri në 7 ditë, kostoja minimale nga shtetet prej nga janë dërguar zarfet është rreth 5 euro ndërsa maksimalja rreth 15 euro. Në mesatare për 35,799 votuesit, të cilët kanë përdorur këto shërbime, kostoja e dërgimit të zarfit me fletëvotim/e është 10 euro. Ndërkohë, për shërbime e shpejta postare nga vendet evropiane çmimi minimal varion nga 30 euro deri te ai maksimal 80 euro. Ndërkohë, për shtetet tjera jashtë kontinentit evropian, çmimet variojnë nga 50 deri në 150 euro. Duke pasur parasysh se shumica e zarfe, si të shpejta poashtu edhe normale, janë dërguar nga shtetet evropiane, mesatarja e çmimit për dërgesat e shpejta postare është 60 euro.

[23]Buxheti i përgjithshëm i KQZ për organizimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit ishte 5 milionë e 650 mijë euro. Kësaj shume i është minusuar kostoja e përafërt për operacionet e votimit jashtë vendit (350 mijë euro) pjestuar me 846,812 votues brenda vendit.

Në total, kostoja totale e dërgimit të zarfeve për votuesit e verifikuar 816,870 euro. Nëse kalkulojmë edhe vlerësimin për shumën e zarfeve të arritura pas afatit ligjor, atëherë kjo kosto arrin shumën 950,250 euro, shumë kjo gati 3 herë me e lartë se kostoja e KQZ për organizimin e votimit jashtë vendit. Mesatarja e çmimit të shërbimit të postës për votuesit jashtë vendit është 35 euro. Nga kjo mund të konkludojmë se koston më të madhe për realizimin e votimit nga jashtë e bartin vetë votuesit.

Tabela 11. Vlerësimi i kostos financiare për votuesit nga jashtë vendit për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2021

	Njësia	Çmimi mesatar *24	Shuma
Shërbime postare normale – pakot e ardhura brenda afatit	35,799 zarfe	€10	€357,990
Shërbime të shpejta postare - pakot e ardhura brenda afatit	7,648 zarfe	€60	€458,880
Shërbime postare normale – pakot e ardhura pas afatit	9,030	€10	€90,300
Shërbime të shpejta postare - pakot e ardhura pas afatit	718	€60	€43,080
		Totali	**€1,300,250**

[24]Çmimi mesatar i shërbimeve postare është nxjerrë si vlerësim, duke u bazuar në çmimoret postës për shërbimet postare të natyrës së zarfeve të dërguara me fletëvotime nga shtetet përkatëse..

PENGESAT NË PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT

Perveç atyre që janë përsëritur nga zgjedhjet/raporti i 2019, mos miratimi nga KQZ i një formulari elektronik për aplikim për regjistrimin e votuesve nga jashtë ka ndikuar në operacionet tjera të KQZ, shtyerja e afateve dhe pamundesia e sfidimit të listës finale të votuesve nga jashtë. Vendimi i KQZ për verfikimin e me telefon të aplikuesve gjithashtu ka ndikuar edhe në përjashtimin e disa personave nga lista e votuesve (edhe pse plotësonin zotesinë juridike), por ka ndikuar edhe në dekurajimin e votuësve tjerë potencial nga diaspora.
Nga të dhënat e prezantuara më lart, por edhe nga evidenca procesve të deritanishme zgjedhore vërehen disa pengesa të cilat ndikojnë që të kemi një numër të vogël të qytetarëve jashtë Kosovës që marrin pjesë në zgjedhje. Më poshtë janë një listë e pengesave për votimin nga jashtë, disa prej të cilave janë përmendur edhe në konsultimet e vazhdueshme që organizata GERMIN i bën me pjesëtarët e diasporës:

1. **MUNGESA E DOKUMENTEVE VALIDE TË IDENTIFIKIMIT:** Shumë qytetarë që jetojnë jashtë vendit duke marrë shtetësinë dhe dokumentet tjera në vendet rezidente, kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës apo nuk i kanë përditësuar dokumentet e identifikimit të Kosovës për një kohë të gjatë. Kjo ndikon në pamundësinë e dëshmimit të kritereve të zotësisë juridike, siç kërkohet nga KQZ për të votuar. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e tyre, duke pasur parasysh procedurat burokratike për përditësimin e dokumenteve dhe mungesën e asistencës institucionale, humbin të drejtën e votës. Në këtë kuptim, një pjesë e qytetarëve (910), të cilët ishin regjistruar dhe dërguar votat me postë, u përjashtuan në procesin e verifikimit me arsyetimin se dokumentet e tyre kishin skaduar. Kjo u pa si e padrejtë për faktin se KQZ kishte vendosur që votuesit brenda vendit mund të votojnë edhe nëse në ditën e zgjedhjeve dokumentet e tyre janë të skaduara.

2. **INFORMIMI DHE NJOHURITË RRETH VOTMIT NGA JASHTË:** Qytetarët e Kosovës jashtë vendit në shumë raste nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre zgjedhore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës. Shumë pjesëtarë të diasporës akoma kanë pak informacion për të drejtat, duke filluar që nga të drejtat për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur e deri tek të drejtat dhe procedurat e ankesës, etj.

Pa qenë të informuar lidhur me të drejtat zgjedhore dhe pa e ditur rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, qytetarët jashtë vendit janë shumë më pak të prirur të votojnë. Poashtu, procedurat e votimit me postë janë burokratike dhe dekurajuese për një pjesë të votuesve potencial.

Printimi dhe plotësimi i formularëve në procedurat e aplikimit dhe regjistrimit, kopjimi dhe skanimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe procedurat e dërgimit të fletëvotimit përmes zarfeve në postën e KQZ-së janë procedura që kanë kosto kohore dhe financiare dhe në shumë raste janë dekurajuese për një pjesë të qytetarëve jashtë vendit. Poashtu, numri i lartë i pakove të refuzuara nga ato që janë pranuar në kohë nga KQZ është indikator për mungesë informacioni mbi procedurat e votimit nga qytetarët jashtë vendit. Informimi i votuesve nga diaspora vazhdon të mbetet një pikë që kërkon më shumë punë dhe angazhim.

KQZ viteve të fundit ka ndërmarrë disa veprime duke targetuar votuesit jashtë vendit, si shembull vendosja e fletushkave informuese në Aeroportin e Prishtinës, që njoftojnë votuesit mbi procedurat e votimit përderisa ata largohen nga Kosova. Poashtu, KQZ-ja ka vënë në dispozicionin përdorimin e metodave elektronike për aplikim dhe regjistrim, dhe një qasje të lehtë në fletëvotime dhe broshura të kandidatëve, pasi që janë të disponueshme në ueb faqen e KQZ. Gjithsesi, përveç kampanjave që organizohen në prag të zgjedhejve, vërehet një mungesë e angazhimit të vazhdueshëm institucional për informim dhe edukim të votuesve nga jashtë. Në këtë drejtim, informimi dhe edukimi mund të jetë më i targetuar duke shfrytëzuar edhe kapacitetet e ambasadave dhe konsulatave të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punëve Jashtme dhe Diasporës, por edhe organizatave të ndryshme të diasporës jashtë vendit.

3. AFATET E SHKURTËRA PËR REGJISTRIM DHE VOTIM: Sipas Rregullës Zgjedhore 03-2013, gjatë cikleve të rregullta zgjedhore votuesit nga jashtë mund t'i dërgojnë aplikacionet për regjistrim mes periudhës, jo më herët se 25 ditë nga shpallja e zgjedhjeve dhe jo më vonë se 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. Gjithsesi, ky afat kohor, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 dhe 2017 është shkurtuar deri në 7 ditë, siç është vepruar në vitin 2019 (12 ditë) dhe 2021 (9 ditë), edhe për shkak se ato kanë qenë të parakohshme. Afati shumë i shkurtër nuk lejon shumë hapësirë për qytetarët jashtë vendit për të përmbushur të gjitha kriteret në procesin e votimit nga jashtë. Poashtu, edhe për ata që regjistrohen suksesshëm, afati për dërgimin/arritjen e zarfeve me fletëvotime në adresë të KQZ-së mbetet sfidues, duke pasë parasysh vonesat postare të cilat nuk janë përgjegjësi e votuesve.

Zgjedhjet e vitit 2021 dëshmuan se një numër i madh i qytetarëve jashtë vendit kanë mundur mos të realizojnë të drejtat e tyre zgjedhore për shkak të arritjes së fletëvotimeve pas afatit ligjor (mbi 9 mijë). Poashtu, shkurtimet e afateve në rastet e zgjedhjeve të parakohshme nuk parashihen as në rregullën zgjedhore për votim jashtë vendit as në LZP. Janë vendimet e KQZ ato që kanë përcatkuar një gjë të tillë, praktikë kjo e cila duhet të ndryshojë dhe të shqyrtohet mundësia e përcaktimit të qartë të afateve brenda kornizës ligjore.

4. VERIFIKIMI I APLIKUESVE PËRMES TELEFONIT: KQZ, me Udhëzimin Administrativ nr.01/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim dhe Votim Jashtë Kosovës, i miratuar përmes Vendimit nr.59-2021 të KQZ-së, ka paraparë procesin e verifikimit të aplikacioneve për periudhen e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës. Ndër të tjera me këtë Udhëzim, është paraparë që Sekretariati do të verifikoj procesin e aplikimit për regjistrim duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit, ashtu që kontaktimi i aplikuesve përmes telefonit ishte ndarë në tre faza. Konsiderojmë se mekanizmi i tillë për verifikimin e aplikimeve, ka pasur për rrjedhoj shkeljen e të drejtës për të marrë pjesë në votim, pasi që në disa raste për shkaqe objektive ka qenë i pamundur kontaktimi i aplikuesve për t'u bërë verifikimi i tyre dhe ky process ka ndikuar negativisht në operacionet tjera zgjedhore si finalizimi i listës së votuesve nga jashtë dhe pamundësia e sfidimit/apelimit të kësaj liste. Prandaj, ky udhëzim dhe kjo formë verifikimi duhet të rishqyrtohet, pasi që reflekton një praktikë jo të mire, me pasoja për të gjithë procesin.

5. TRAJTIMI JO-SERIOZ I VOTIMIT NGA JASHTË: Instituconet relevante deri më tani nuk e kanë trajtuar me seriozitetin e duhur procesin e votimit nga jashtë. Fakti që të njejtat probleme përsëriten dhe pengesa të tjera shtohet tregon për mos gatishmërinë e institucioneve përgjegjëse për adresimin e tyre. Me përjashtime të vogla, një pjesë e madhe e akterëve politik në heshtje e injorojnë përmirësimin e këtij procesi dhe kuadrit ligjor, ndërsa institucionet e thirrura për të bërë veprimet e nevojshme nuk kanë ndërmarrë asgjë deri më tani. Në këtë drejtim, votimi nga jashtë deri më tani është parë si çështje dytësore në debatin për reformën zgjedhore. Që nga viti 2018 ka nisur procesi i amandamentimit të LZP, përkatësisht pjesës së votimit jashtë vendit, mirëpo nuk kemi akoma një epilog edhe pse ka një draft të miratuar në Komisionin Parlamentar për Legjislacion gjatë legjislaturës së gjashtë dhe shtatë të Kuvendit të Kosovës.

ALTERNATIVAT E VOTIMIT NGA JASHTË KOSOVËS

1. VOTIMI FIZIK NË MISIONET DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky model votimi kërkon miratimin e ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht kapitullit 14 (kreu XIV) të këtij ligji. Këto ndryshime janë para parë në draftin ekzistues të miratuar në Komisionin për Legjislacion gjatë legjislaturës së 6-të dhe nevojitet votimi/miratimi tyre me votën e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Me këto ndryshime vendoset baza ligjore për mundësimin e votimit nëpër ambasada dhe konsullata të Republikës së Kosovës. Por, për zbatimin e tij nevojitet gjithashtu edhe draftimi dhe miratimi i legjislacionit plotësues/dytësor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Regjistrimi i pjesëtarëve të diasporës nga ish-Ministria e Diasporës nuk ka arritur të mbledhë të gjitha të dhënat e qytetarëve jashtë vendit. Mirëpo edhe si i tillë, ky regjistër nuk është përdorur deri më tani nga ana e KQZ-së për krijimin e një liste të veçantë të qytetarëve jashtë vendit e cila mund të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Poashtu, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të bashkëpunoj me Komisionin Qendor të Zgjedhjeve që të vendos një kod identifikues për shtetasit e Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit në regjistrin civil, sikurse që ekziston kodi për shtetasit që nxjerrin dokumente të Republikës së Kosovës në ambasada dhe konsullata jashtë vendit.[25]

Ky model kërkon gjithashtu të shqyrtohet edhe aspekti i përfaqësimit të votuesve dhe gjithë sistemit zgjedhor vendor – aktualisht proporcional kombëtar. Shumë shtete që përdorin këtë model kanë krijuar zona të veçanta zgjedhore për votuesit jashtë vendit dhe kuota specifike të përfaqësimit. Gjithashtu, duhet të specifikohet për cilat lloje të zgjedhjeve lejohet kjo formë votimi pasi që mund të ketë implikime organizative, financiare dhe të sigurisë (p.sh. sistemi me dy raunde në zgjedhjet lokale do të ishte vështirë i realizueshëm përmes këtij modeli jashtë vendit.). 109 shtete aktualisht përdorin këtë formë të votimit nga jashtë.[26]

Përparësitë e votimit fizik:

- Transparencë më e lartë e procesit të votimit
- Kushte të barabarta votimi për qytetarët jashtë vendit
- Nxit pjesëmarrje më të lartë në votime dhe siguron fshehtësinë e votës

Mangësitë e votimit fizik:

- Kosto e lartë financiare dhe organizative
- Koha e nevojshmë për përgatitje është me e madhe – mund të afektojë zgjedhjet e parakohshme/jashtëzakonshme
- Qasje e vështirë në qendrat e votimit në shtetet gjeografikisht të mëdha

2. ZGJERIMI I MUNDËSIVE PËR VOTIM PËRMES POSTËS

Përveç mundësisë aktuale të votimit, zgjerimi i mundësive për votim përmes postës mund të përfshij edhe mundësinë e dërgimit e postës në ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendin rezident të qytetarëve jashtë vendit. Kjo pasiqë afatet e shkurtra shpesh po e pamundësojnë dërgimin e zarfeve me fletëvotime nëkohë në adresë të KQZ-së, prandaj duhet të krijohet mundësia që vota me postë të dërgohet në misionin diplomatik/konsullor në të njejtin shtet, krahas mundësisë për dërgimin e postës në adresë të KQZ-së. Votat përmes postës arrijnë shumë më shpejtë brenda territorit të një shteti. Ndërsa të njejtat, misioni diplomatik apo konsullor mund t'ia dërgojë me postë diplomatike KQZ-së. Kështu do të zgjeroheshin mundësitë aktuale të votimit dhe procesi do të përshpejtohej.
Poashtu, formave aktuale të aplikimit për regjistrim si votues nga jashtë vendit, rekomandohet t'u shtohet edhe një platformë elektronike në uebfaqen e KQZ-së e cila do të mundësonte aplikimin online për regjistrim (web-based). Një platformë e tillë do të: (1) lehtësonte dhe thjeshtësonte në krahasim me formën aktuale manuale duke qenë se nuk do të kishte nevojë për printim/plotësim të formularit; (2) zvogëlonte mundësitë e gabimeve në futjen e të dhënave, duke qenë se ajo mund të konfigurohet që të mos pranojë të dhënat e gabuara dhe aplikuesit do të mund të korrigjonin të dhënat e tyre; (3) menjanonnte mbingarkesën e e-mailit zyrtar të KQZ-së që ka qenë problem në zgjedhjet e kaluara.

Përparësitë e votimit përmes postës:

- Kosto e ulët financiare dhe organizative
- Qasje e lehtë për votuesit pavarësisht vendit të banimit

Mangësitë e votimit përmes postës:

- Transparencë e ulët
- Votimi familjar
- Varësi ndaj shërbimeve postare dhe kosto e lartë për votuesit

[25] "VOTIMI NGA JASHTË VENDIT: Shqyrtimi i Politikave dhe Rekomandime Praktike". 2018. Instituti Demokraci Për Zhvillim (D4D) Dhe Demokraci Plus (D+). https://d4d-ks.org/ëp-content/uploads/2018/10/D4D_Elec_13_SHQ.pdf.
[26] Për më shumë, shih databazën e Institutit për Demokraci dhe Asistencë Elektorale (IDEA). E qasshmë: https://www.idea.int/data-tools/world-view/52

3. VOTIMI ELEKTRONIK

Votimi elektronik nga diaspora do të ishte i shpejtë dhe efikas. Sidoqoftë, teknologjia informative, infrastruktura dhe masat përcjellëse të sigurisë paraqesin sfida serioze për zbatim të sukseshëm. Ndërhyrja nga akterë të jashtëm në procesin zgjedhor, siç ka ndodhur në disa vende, paraqet një rrezik të lartë për manipulim të rezultateve. Votimi elektronik është posaçërisht i rrezikuar nga hakingu apo manipulimi digjital. Përgatitja e një sistemi nga zeroja që do të mbronte informatat e votuesve dhe transmetimin e të dhënave është e komplikuar. Poashtu, nevojitet një kornizë ligjore për caktimin e kriterve për identifikimin e votuesve (për shembull lexues smart të letërnjoftimeve) që do të përdorinin votimin elektronik. Estonia është një shtet ku një e katërta e votuesve përdorin internetin për të votuar dhe mund të shërbejë si shembull studimi i mundshëm për Kosovën për të vlerësuar potencialin dhe sfidat e votimit elektronik.

Përparësitë e votimit elektronik:

- I qasshëm në gjithë botën
- I shpejtë dhe pa vonesa në cfarëdo lloji të zgjedhjeve
- Ulë koston e gabimeve njerëzore në proces

Mangësitë e votimit elektronik:

- Shqetësime/dyshimet e aspektit të sigurisë
- Kosto të lartë zbatimi dhe mirëmbajtje

BIBLIOGRAFIA

1. "ANKESË Drejtuar PZAP: Për Shkeljen e së Drejtës së Votës ndaj Qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit". 2019. OJQ GERMIN. https://germin.org/ankese-drejtuar-pzap-per-shkeljen-e-se-drejtes-se-votes-ndaj-qytetareve-te-republikes-se-kosoves-qe-jetojne-jashte-vendit/

2. "APEL i vendimit Anr. 382/2019 të PZAP: drejtuar GJykatës Supreme të Republikës së Kosovës" 2019. OJQ GERMIN. https://germin.org/germin-paraqet-ankese-ne-gjykaten-supreme-per-mosnumerimin-e-1806-pakove-me-fletevotime-nga-diaspora-nga-ana-e-kqz-se/

3. "Mbledhja e Datës 18 Shtator". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. http://www .kqz-ks.org/lajmet/periudha-e-votimit-permes-postes-fillon-me-19-shtator/

4. "Migrimi Kosovar". 2014. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf

5. "Raport përfundimtar për Periudhën e Votimit përmes postës – Votimi jashtë Kosovës 2019". 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

6. "Report On Out-Of-Country Voting". 2011. Venice Commission. https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)022-e

7. "RREGULLA ZGJEDHORE Nr.3/2013 - VOTIMI JASHTË KOSOVËS". 2013. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. http://www.kqz-ks.org/ëp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-03-2013.pdf

8. "Vendosja e Drejtësisë Në Zgjedhje: Shqyrtimi i Rasteve dhe Rruga Drejt Bashkëpunimit Institucional". 2015. Democracy For Development (D4D). https://d4d-ks.org//assets/2015-07-10-Electoral-Justice-Report-ALB.pdf

9. "VOTIMI NGA JASHTË VENDIT: Shqyrtimi i Politikave dhe Rekomandime Praktike". 2018. Instituti Demokraci Për Zhvillim (D4D) Dhe Demokraci Plus (D+). https://d4d-ks.org/ëp-content/uploads/2018/10/D4D_Elec_13_SHQ.pdf

10. “Procedura për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës: Votimi jashtë Kosovës”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). http://ww-wëëë.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/ (Qasur me 20 dhjetor, 2019.)

11. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A.A.-U.ZH.nr.20/2019, datë 30.08.2019, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A.A.-U.ZH.nr.21/2019, datë 05.11.2019.

12. Krasniqi, Lirim. 2018. "Vota e Diasporës si Infuzion i Demokracisë". GERMIN & KALLXO.Com. https://kallxo.com/gjate/mendime/vota-e-diaspores-si-infuzi-on-i-demokracise/

13. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. "LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

14. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. ".LIGJI NR. 03/L-034 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS". Prishtinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

SHTOJCA

PËRPJEKJET E GERMIN PËR MBROTJEN E TË DREJTËS SË VOTËS PËR DIASPOREN

Me datë 11.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (tutje KQZ) KISHTE marrë një vendim Për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës.

Përmes këtij vendimi ishte përcaktuar mënyra e verifikimit të aplikuesve për regjistrim si votues jashtë Kosovës si vijon, citoj: KQZ-ja do të verifikoj procesin e aplikimit për regjistrim, duke i kontaktuar të gjithë aplikuesit përmes telefonit; në piken IV e këtij vendimi vijon, citoj: Nëse aplikuesi nuk lajmërohet në telefon, atëherë aplikacioni i tij refuzohet.

Germin ka konsideruar që ky vendim i KQZ-së nuk ishte në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 22, 45, 53, 55; Ligjin Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe as Procedurën për Vlerësimin e Kritereve të Zotësisë Juridike për Fitimin e së Drejtës së Votës për Votimin Jashtë Kosovës. Konkretisht ky vendim është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventa Ndërkombëtare.

Baza Ligjore: Sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (tutje "Kushtetuta") citoj: "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj".
Kushtetuta, në nenin 45, i përkufizon të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes si vijon, citoj: 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Në lidhshmëri me nenin 53 të Kushtetutës: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Në raport me kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, Kushtetuta, përmes nenit 55, përcakton, citoj:
1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.
Ligji Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (tutje si citoj:: "Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme") përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organ i pavarur përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 1.c, citoj: rregullon njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret e pranueshmërisë së votës. Ndërsa neni 2 i këtij ligji, në parim e përfshin edhe të drejtën që: "Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji", dhe që: "Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar . . ."

Të drejtën për të votuar, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e garanton/definon me nenin 5, si vijon: citoj: "Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kritereve vijuese: a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t'i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës".

Aplikimi për Votim Jashtë Kosovës përcaktohet me nenin 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: "96.1 citoj: Votuesi me të drejtë vote i cili përkohësisht mungon në Kosovë mund të votojë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës nëse ai ose ajo ka aplikuar suksesshëm për Votim Jashtë Kosovës dhe ka votuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së"; Neni 97 Aplikimi për Fletëvotim "97.1 Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për Votim Jashtë Kosovës duke dorëzuar të plotësuar Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës/Formularin e Regjistrimit të Votuesit ("Aplikimi Përmes-Postës")në formën në dispozicion nga faqja elektronike e KQZ-së":

Procedura për kriteret juridike për votimin jashtë vendit përcaktohet me Procedurën për Vlerësimin e Kritereve të Zotësisë Juridike për Fitimin e së Drejtës së Votës për Votimin Jashtë Kosovës, e cila bazohet në Ligjin Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës; Ligjin Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës; Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2000/ 13 mbi Zyrën Qendrore të Gjendjes Civil (që është në fuqi sipas Ligjit për Shtetësi); Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 04/2014 Për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës; dhe Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 05/2014 për Kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish – RFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës me 1 janar 1998.

Dëshmia e identitetit të personit për të përmbushur kriteret e zotësisë juridike përcakohet në Procedurën për Vlerësimin e Kritereve të Zotësisë Juridike për Fitimin e së Drejtës së Votës për Votimin Jashtë Kosovës, pika 2: Për të dëshmuar identitetin tuaj, ju duhet të dërgoni një dokument të vlefshëm zyrtar me fotografinë tuaj. SHEMBULL: Dokumenti i vlefshëm i identifikimit, Pasaportë valide, Dokument i vlefshëm i udhëtimit, Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, Kartela e vlefshme e PZH-BV-ve dhe Kartela e vlefshme e refugjatit.

Dispozitat që e rregullojnë procesin e ankesave dhe apelimit të vendimeve të KQZ pranë PZAP, përcaktohen me nenin 122, 122.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: "Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP"; nenin 122.2: "KZAP-i do të mbështesë apelin ndaj vendimit të KQZ-së nëse vlerëson se KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të të gjitha rrethanave"; nenin 122.3: "Nëse KZAP-i mbështet apelin ndaj vendimit të KQZ-së, mundet të: a) udhëzojë KQZ-n ta rishqyrtojë vendimin e vet; dhe b) udhëzojë KQZ-në të marrë masa kompensimi"; dhe Rregullën NR.2/2015, neni 5.

Germin ka vlerësuar që praktika e GJEDNJ, përkitazi me nenin 3 të Protokollit Nr. 1, nuk ua imponon shteteve që të garantojnë votimin për shtetasit jashtë vendit dhe e lë në diskrecionin e tyre nëse duan të organizojnë votimin nga jashtë. Megjithatë, përmes çështjes Sitaropoulos dhe të tjerët kundër Greqisë, ne kemi një precedent i cili përcakton që nëse shtetet parashohin ushtrimin e të drejtave zgjedhore për shtetasit jashtë vendit, atëherë ato duhet të sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave në mënyrë të plotë, përkundrazi bëjnë shkelje të nenit 3 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së. Prandaj, përderisa Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës parashohin ushtrimin e të drejtave zgjedhore për shtetasit jashtë vendit, ligjet që e rregullojnë procesin e votimit jashtë vendit do të duhet të sigurojnë zbatimi e këtyre të drejave në mënyrë të plotë, duke iu nënshtruar në veçanti kërkesave kushtetuese. Pasë parasyshë këtë qëndrim legjislativ të Kosovës, ngarkimi i qytetarëve jashtë vendit me procedura shtesë në krahasim me qytetarët e tjerë do të ishte në kundërshtim ndër të tjera edhe me Nenet 3 dhe 24 të Kushtetuës sepse cenon drejtpërdrejtë parimin kushtetues të "barazisë para ligjit" dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, e që në rastin konkret është bërë cënimi i kësaj të drejtë përmes rregullave të përcaktuara nga KQZ përmes vendimit të përmendur.

Ashtu sikurse është përcaktuar me Kushtetutën e vendit, përfshirë edhe instrumentet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, e drejta e votës është e garantuar, e aplikuar ndaj çdo qytetari të Republikës që ka arritur moshën 18 vjeçare. Në pajtim me këtë janë hartuar dhe miratuar Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ai për Zgjedhjet Lokale por edhe Rregullat e KQZ-së që e përcaktojnë në mënyrë më të detajizuar procesin zgjedhor.

Qytetarët të cilët aplikojnë duke plotësuar formularin për aplikim të KQZ mund të mos jenë të qasshëm për kontakt përmes telefonit në momente të caktuara për shkaqe teknike që dalin jashtë përgjegjësisë së tyre. Prandaj, vendimi i KQZ-së (datë 11.01.2021), përkatësisht pika IV mund të krijojnë kushte të refuzimit të aplikacioneve për regjistrim për votim nga jashtë për arsye që nuk janë përgjegjësi e votuesit, duke shkaktuar shkelje të të drejtave zgjedhore të garantuara me nenin 45, lexuar bashkë me nenin 55 të Kushtetutës, pasi që mund të krijohet kufizimi që mohon esencën e të drejtës së garantuar.

Nga kjo vërtetohej fakti vendimtarë që ka të bëjë më pengesat teknike apo të çfarë do natyre që nëse një qytetarë mudn të jetë në orar të punës, në problem shendetësore apo në çfardo forme të caktuar të mos ketë qasje telefonike atij do të i mohohet respektivisht do të privohet nga e drejta e tij Kushtetuese për të zgjedhë, kjo paraqet shkelje apsolute dhe pamundësim që qytetarët e njejtë të bëjnë kthimin në gjendjen (kthimin e të drejtës) se më hershme sepse ata do të njifen me këtë mohim/pengim vetëm pasi të përfundon procesi zgjedhor e që praktikisht del që pasoja e tillë është evidente që rezulton në humbjen e të drejtës për të zgjedh. Kjo edhe në kundërshtim më Kodin Penal të Republikës së Kosovës neni 59 par 2.1 dhe neni 60, që si dënim mnd të shqiptoj vetem Gjykata dhe për me tepër paraqet edhe veper penale të përcaktuar nga kapitulli XVIII veprat penale kundër të drejtave të votimit neni 209 „Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar„ dhe Neni 215 ''Cenimi i fshehtësisë së votimit''.

Neni 55, 4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël. 5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.

Pika IV e vendimit të KQZ-së nuk ishte në përputhje as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht kriteret për fitimin e zotësisë juridike për fitimin e të drejtës së votës si vijon: Për tu përfshirë në Listën e Votuesve jashtë Kosovës, kriteret që duhet të dëshmohen janë 1. Identiteti juaj, 2. Mosha juaj, 3. Të keni kryer regjistrimin civil në Republikën e Kosovës, ose 4. Të keni qenë banorë i Kosovës më 1 janar 1998.

Pika IV e këtij vendimi shkon përtej dëshmisë së identitetit të personit për të përmbushur kriteret e zotësisë juridike të përcaktuara në Procedurën për Vlerësimin e Kritereve të Zotësisë Juridike për Fitimin e së Drejtës së Votës për Votimin Jashtë Kosovës, sic përcakton pika 2: Për të dëshmuar identitetin tuaj, ju duhet të dërgoni një dokument të vlefshëm zyrtar me fotografinë tuaj. SHEMBULL: Dokumenti i vlefshëm i identifikimit, Pasaportë valide, Dokument i vlefshëm i udhëtimit, Leja e vozitjes e vlefshme e Kosovës, Kartela e vlefshme e PZHBV-ve dhe Kartela e vlefshme e refugjatit.

Në këtë mëyrë përmes mekanizimit të krijuar të "thirrjës telefonike" paraqet një precendent të pa hasur në praktike dhe të rrezikshëm për sigurinë juridike të qytetarëve, sepse në asnjë procedure administrative e as gjyqësore nuk mund të përdoret standardi i besueshmërisë e aq më pak provueshmërisë së fakteve përmes thirrjes telefonike të cënohet kjo e drejtë Kushtetuese mbi këtë bazë.

Përveq shkeljeve kushtetuese të potencuara si më sipër, vlenë të potencohet se si organ administrativ, KQZ ka për obligim që vendimet e saj të shkruara ti hartojë në përputhje me obligimet formale që derivojnë nga Neni 47 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Nga shikimi i thjeshtë i këtij vendimi, shihet qartë se ky Vendim është absolutisht i pavlefshëm. Paragrafi 1.3 i Nenit 47 citoj: se akti administrativ i shkruar duhet ndër të tjera të përmbajë edhe "pjesën arsyetuese". Ekzaminimi i Vendimit në fjalë reflekton se në këtë Vendim nuk ka fare arsyetim—ndërsa, pasë parasyshë cenimin potencialisht kushtetues dhe ligjor që ngërthen në vehte ky Vendim, obligon KQZ-në edhe më tepër që të arsyetojë pse po bënë ngarkesa të tilla shtesë për një pjesë të qytetarëve votues.

Në bazë të praktikës gjyqësore, mungesa e arsyetimit të vendimit paraqet bazë për anulimin e tij ngase subjekti të cilit i drejtohet/kufizohet apo pamundësohet realizimi i një të drejtë është privuar nga sqarimi/arsyetimi se pse i është bërë vendosja e këtij privimi. Kjo e drejtë e njohjes me arsyetimin është parameter matës i respektimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve (shif nenin 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative).

Dhe sa për sqarim, ky Vendim nuk bjen në kuadër të përjashtimeve të parapara me Nenin 49 në asnjë pikë të tij të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse në rastin konkret ky Vendim cenon të drejtat e një pjese relativisht të madhe të qytetarëve votues. Thënë atë, në bazë të Nenit 55(4) të Kushtetutës, KQZ ka pasë për detyrë të arsyetojë dhe "t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël", dhe të arsyetojë secilën nga këto në vendimin që e ka marrë. Në mungesë të kesaj, ky Vendim ishte aboslutisht i pavlefshëm.

Dhe përfundimisht konsiderojmë që është bërë shkelja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve del edhe nga fakti se po të i referohemi vendimeve te GJEDN, konkretisht rastit no. 8950/80 Affaire H.c. Belgique, vendimi nr. 49684/99 Hirvisaari c. Finlande, etj) të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmes së cilit paraqitet detyrimi i organit për dhenjen e arsyeve të vendimit.

Në rastin konkret, KQZ përveq që ka lëshuar një vendim absolutisht të pavlefshëm, njëheri, ka abuzuar edhe me discrecionin administrativ që posedon. Ushtrimi i Diskrecionit nga organet administrative rregullohet me Nenin 4 dhe 5 të LPPA-së që përcaktojnë se ushtrimi i pushtetit diskrecionar është subjekt i rishikimit në raport me proporcionalitetin dhe arsyeshmërinë e masave, duke përcaktuar se:

Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendim-marrje (në vijim "diskrecioni"), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte:
3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin;
3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe
3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore.
..
2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte:
2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj;
2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe
2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa për dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 Germin kishtë paraqitur ankesë me pretendimet që:

- Prezantohen fakte të reja
- Cënohen të drejta Kushtetuese / Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes
- Cënohen dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme
- Cënohen dispozitat e Kodit Penal
- Mohohet/kufizohet e drejta për ushtrimin e mjetit Juridik në bazë të nenit 118 par 4.

Germin si palë me interes në këtë procedurë, ka paraqitur ankese më datë 12.01.2021 përmes së ciles kishte dhënë pretendimet për shkelje të mjaftueshme të cilat kanë ndikuar në nulitetin e vendimit të KQZ por që Panelit Zgjedhor për Ankesa për dhe Parashtresa përmes vendimit A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 ka bërë hudhjen e ankesës si të palejueshme duke konstatuar që: Vendimi i KQZ nuk hynë në në kategorinë e vendimëve që mund të apelohen në bazë të nenit 122, Vendimi i KQZ është i natyrës teknike, Vendimi nuk prek apo cënon një të drejtë themelore të votuesëve në bazë të nenit 64, dhe Mohimi/kufizimi i të drejtës për ushtrimin e mjetit Juridik në bazë të nenit 118 par 4.

Germin kishte pretender që përmes vendimit A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 ka bërë shkelje të të drejtave themelore të njëriut, ashtu që këto shkelje kanë reflektuar në krijimin e pasojave juridike të qytetarëve, pretendojmë që përmes këtij vendimi PZAP ka bërë Cënimit të të drejtave Kushtetuese / të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes, Cënimit të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Cënimit të dispozitave të Kodit Penal dhe Mohimi/kufizimi i të drejtës për ushtrimin e mjetit Juridik në bazë të nenit 118 par 4.

Konstatimi i PZAP ishte se Vendimi i KQZ nuk hynë në në kategorinë e vendimëve që mund të apelohen në bazë të nenit 122, Germin ka konsideruar që ky konstatim përmes vendimit A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 nga ana e PZAP ishte kundërligjor, i pa arsyeshëm dhe si i tillë i pa qëndrueshëm ngase nga analizimi logjik i dispozitës së nenit 122 citojmë: 122.1 Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP,,

Tutje, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme jap mundësitë e paraqitjës së ankesës (kjo e drejtë Kushtetuese), me çka ky nen garanton të drejtën Kushtetuese dhe ligjore të ushtrimit të mjetit Juridik ndërsa në pikat a, b,c,d,e,f jep shkaqet/bazat e paraqitjës së ankesës. Në rastin konkret kemi të bëjmë më interpretim tërsisht të gabuar të kësaj dispozite dhe njëanëshmërisë së interpretimit gjoja se ankesa hudhet si e palejueshme sepse nga pikat e ketij neni përcaktohen bazat e paraqitjës së ankesës por nuk mohon/pengon të drejtën e ankesës. Vet konstatimi i tillë ka kundërthënje në vetvete.

Ky konstatin i PZAP është në undërshtim me: Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenet 22, 45, 53, 55; Ligjin Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës neni 1.c, 2, 5, 122, Kodin Penal neni 209 dhe 215, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 47,48, 49 dhe vendimeve te Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht rastit no. 8950/80 Affaire H.c. Belgique, vendimi nr. 49684/99 Hirvisaari c. Finlande, etj).
Në faqe dy të vendimit A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 paragrafi i dytë, PZAP lëshohet në vlerësimin meritor të ankesës ashtu që i referohet nenit 122 par 1 dhe drejtë ka përshkruar pretendimin e ankuesit me rrezikimin/cënimin e të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje, por gabimisht konstaton që ankesa hudhet e palejueshme e tëra kjo në mungesën e arsyes për të bërë refuzimin e saj dhe në mënyrë kundërligjore zgjedhet rruga e hudhjës së saj që vendimin e permendur e bënë tërsisht të pa ligjshem.

Paligjshmëria e vendimit shtrihej edhe tutje, ku PZAP i referohet Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nenit 63 par 3 që citoj: "Vendimet e Komisionit nuk I nënshtrohen ankesës përveq nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj", në këtë rast PZAP ka bërë aplikimin e gabuar të kësaj dispozitë sepse dispozita e nenit 63 par 3 përcakton: citoj" 63.3 Takimet e KQZ-së vlejnë vetëm nëse në to marrin pjesë jo më pak se shtatë (7) anëtarë të KQZ-së. Kjo vërteton që është bërë në tërsi aplikimi i gabuar i të drejtës materiale LZP.

Për më teper PZAP kishte bërë anashkalimin e zbatimit të LZP konkretisht nenit 118 par 1 ku decidivisht lejohet mundësia e paraqitjës së ankesës, citoj: 118.1 KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet. Madje edhe vet funksionimi i PZAP është siaps nenit 3 të LZP i cili përcakton domethënjën e nocionit të "KZAP" do të thotë Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor dhe "KQZ" do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve; kjo e rregulluar edhe me nenin 98 të LZP.

Referimi nga ana e PZAP në aplikimin e nenit 64 par 2 të LZP ku përcaktohet përgaditja e formave dhe procedurave, nuk përbën argument lidhur me refuzimin e ankesës sepse vendimi i KQZ nuk ka të bëjë me procedura dhe veprime, por ka të bëjë me pasojen e humbjes së të drejtës material-përmbajtësore-meritore/ të drejtës në shfrytësimin e pjesëmarrjës në zgjedhje/votimit. Prandaj gabimisht është bërë konstatmi se ky vendim nuk ndikon në të drejten themelore të votuesit, lind pyetja se çka nëse votuesi ka probleme me energji elektrike, telefon, rrjet, probleme shendetësore etj,,,,, ku do të krijohej/kompensohej mundësia e të drejtës së votimit.

Kjo vërtetohet edhe nga fakti se nga neni 64 par 2 pika c) citoj: krijon dhe mban listën e personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta; që nga vendimi i KQZ del që nuk është bërë krijimi i listës sespe ende nuk është bërë telefonimi i qytetarëve dhe nuk dihet nëse ata do të jenë në listë me të drejtën e votimit, pra del që vendimi i KQZ ka efekt përmbajtësor dhe jo teknik siq është munduar të bëhet interpretimi duke u thirrur edhe ne nenin 122 pa ju referuar par 1 por vetem pikave të këtij neni që flasin për bazueshmërinë e pretendimëve ankimore.

Vendimet e ankumuara edhe vendimi i KQZ por edhe vendimi i PZAP janë nxjerrë me përfshirje të cënimit të dispozitave të Kodit Penal e që reflektojnë si të tilla ngase:

Kjo edhe në kundërshtim më Kodin Penal të Republikës së Kosovës neni 59 par 2.1 dhe neni 60, që si dënim mund të shqiptoj vetëm Gjykata dhe për me tepër paraqet edhe veper penale të përcaktuar nga kapitulli XVIII veprat penale kundër të drejtave të votimit neni 209 „Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar„ dhe Neni 215 "Cenimi i fshehtësisë së votimit".

Përfundimisht, mohimi i të drejtës së ushtrimit të mjetit Juridik nga ana e PZAP përmes vendimit të atakuar paraqet edhe elemente të vepres panele duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës nenit 118.4 citoj: Mund të apelohet vendimi i KZAP-it, sikurse që KZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës pranohet në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa 5,000 euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme u jep përparësi këtyre apeleve.

Deri të kjo gjendje kemi ardhur kur PZAP përmes vendimit në pjesën e këshilliës juridike ka shkruar që kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, më këto veprime pretendohet në ndërmarrjen e veprimeve në kundërshtim me Kodin Penal neni 205 Cenimi i së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik.

GERMIN e ka dëshmuar përfaqësimin e interesave dhe mbrojtjen e të drejtave zgjedhore të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit në disa cikle zgjedhore, duke qenë organizata e parë joqeveritare në Kosovë që ka vëzhguar procesin e aplikimit, regjistrimit dhe votimit përmes postës në tre palë zgjedhje të fundit për Kuvendin e Kosovës. GERMIN si organizatë joqeveritare ka të drejtën e avokimit dhe mbrojtjes të të drejtave themelore (përfshirë të drejtat zgjedhore) për të gjithë qytetarët e Kosovës pavarësisht vendit ku ndodhen. Kujtojmë që ne kemi hapur një e-mail të posaçëm pranuar ankesa nga disa qytetarë që jetonë jashtë Kosovës dhe të cilët kanë deklaruar që nuk posedojnë telefon (shif një ankesë të tillë në bashkangjitje)

Prandaj, konsiderojmë që Germin ka ofruar prova dhe argumente të mjaftueshme ligjore vendore dhe ndërkombëtare për të bërë të besueshëm pretendimin që vendimi i atakuar është i paligjshëm dhe kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, që sipas mandatit që ia jep Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 122.3: a) udhëzojë PZAP-n ta rishqyrtojë vendimin e KQZ të datës 11.01.2021, apo është dashur që PZAP të Aprovoj këtë ankesë në tërësi si të bazuar dhe të bëjë anulimin e vendimit të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) Për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim Për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës si të paligjshëm dhe të ndryshoj vendimin e vet A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021 të atakaur tani përmes kësaj ankese, në të kundërtën, kërkojmë nga Gjykata Supreme që të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e datës 15.01.2021 dhe të anuloj vendimin e KQZ të datës 11.01.2021 dhe vendimin e PZAP A.nr.1/2021 të datës 13.01.2021.

germin

VOTIMI JASHTË VENDIT 2021

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga Ambasada Zvicerane, programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë' bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Partner i këtij projekti është edhe Fondacioni "Friedrich Ebert (FES)" - Zyra në Prishtinë. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjsi e GERMIN dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF, SDC, Sida apo FES.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sweden
Sverige

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG